



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTIRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT
MINISTRARSTVO EKOONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA E KOSOVËS PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË/ KOSOVSKA AGENCIJA ZA EFIKASNOST I ENERGIJU/
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY AGENCY

KËRKESAT për PËRZGJEDHJEN dhe AUTORIZIMIN e INSTITUCIONIT të
TRAJNIMIT për OFRUESIT e SHËRBIMEVE ENERGJETIKE
(auditorët e energjisë, vlerësuesit e energjisë, ekspertët e pavarur)

AKEE publikon thirrjen për shprehje të interesit për institucionet e trajnimit

Kriteret e pranueshmërisë për institucionin e trajnimit dhe vlerësimi i periudhës së pranueshmërisë dhe autorizimit për institucionin e trajnimit:

1. Trajnimi i ofruesve të shërbimeve energjetike sigurohet nga personat juridikë që kanë marrë autorizim nga Ministria për ofrimin e programeve të trajnimit për ofruesit e shërbimeve energjetike në pajtim me këtë Rregullore.
2. Trajnimi i ofruesve të shërbimeve energjetike ofrohet në përputhje me programin e trajnimit të Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 të kësaj Rregulloreje dhe programin e trajnimit siç përcaktohet në Ligjin Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Certifikimi sipas Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 vlen për pesë (5) vjet dhe mund të rivalidohet/rivlerësohet për të njëjtën periudhë dhe sipas kushteve të njëjta në përputhje këtë Rregullore.
4. Certifikimin sipas Rregullores (MEPTINIS) Nr. 05/2020 mund ta marrë personi juridik në përputhje me nevojat e infrastrukturës për një ofrues të trajnimeve për ofruesit e shërbimeve energjetike që janë përshkruar në Shtojcën 3 të kësaj Rregullore.

Kërkesa për certifikim të institucioneve të trajnimit për ofruesit e shërbimeve energjetike duhet t'i dorëzohet AKEE-së, e cila duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Një kopje e diplomës së ekspertëve që do të zbatojnë programin e trajnimit.
- Rezymetë e ekspertëve që do ta zbatojnë programin e trajnimit.
- Programin e detajuar të trajnimit në përputhje me Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të kësaj Rregullore dhe programin e trajnimit siç përcaktohet në Ligjin Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- Përmbajtjen dhe mënyrën e ekzaminimit për testimin e njohurive të pjesëmarrësve në Programin e Trajnimit.

Institucioni i Trajnimit është i obliguar që:

o Të zbatojë programin e trajnimit në përputhje me Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2 të kësaj Rregullore dhe programin e trajnimit siç përcaktohet në Ligjin Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

o të sigurojë arsim të vazhdueshëm profesional për ofrues të certifikuar të shërbimeve energjetike,

o të kontrollojë identitetin dhe praninë e personit që ndjek programin e trajnimit,

o të testojë njohuritë e personit që ndjek programin e trajnimit,

o të mbajë një regjistër të personave që kanë përfunduar programin e trajnimit,

o të raportojë në AKEE-së për zbatimin e programit të trajnimit,

o t'ia mundësojë AKEE-së që të mbikëqyrë zbatimin e programit të trajnimit dhe detyrimet e tjera në përputhje me Rregulloren (MEPTINIS) Nr. 05/2020.

Institucioni i autorizuar për ofruesit e shërbimeve të energjisë në përputhje me Rregulloren (MEPTINIS) Nr. 05/2020 mund të kryejë trajnime për vlerësuesit e energjisë dhe ekspertët e pavarur të mbuluar nga Ligji Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa.

SHTOJCA III - Infrastruktura e nevojshme për një ofruer të trajnimit për OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË ENERGJETIKE

Kërkesat	Shpjegim
Regjistrimi për aktivitete arsimore	Ekstrakt nga regjistri i Gjykatës Komerciale, duke dëshmuar se institucioni/shoqëria është e regjistruar për kryerjen e aktiviteteve arsimore
Së paku gjashtë ekspertë që do të ofrojnë trajnime	<p>Trajnerët duhet të kenë kualifikimin e kërkuar arsimor (të paktën një nivel Master ose Doktoratë në arkitekturë/ndërtimtari, një në inxhinieri mekanike dhe një në inxhinieri elektrike).</p> <p>Trajnerët mund të jenë dhe mos të jenë staf i përhershëm i institucionit (të paktën njëri duhet të jetë punonjës i institucionit) - nëse trajnerët janë punonjës të institucionit, personi përgjegjës i institucionit duhet të deklarojë se do të jenë në dispozicion për kryerjen e trajnimit; në rast se trajneri nuk është punonjës i institucionit, duhet të sigurohet një deklaratë e disponueshmërisë dhe ekskluzivitetit.</p> <p>Trajnerët duhet të kenë së paku 10 vjet përvojë profesionale në një fushë të lëndës.</p>
Objektet në të cilat do të mbahet trajnimi	<p>Duhet të dorëzohet një dëshmi e pronësisë ose qiramarrjes për objektin me një madhësi të përshtatshme në mënyrë që të sigurohet mësimdhënie cilësore për qëllime të arsimit të lartë. Duhet të sigurohen sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapësirë për mësimdhënie prej së paku 1,25 m² për student • Pajisjet për prezantim (kompjuter dhe projektor); • Pajisje printimi; • Lidhje interneti
Pajisjet e matjes	<p>Duhet të dorëzohet një listë e pajisjeve që janë në posedim ose në dispozicion (kontratë për qiradhënie) të institucionit.</p> <p>Pajisjet e kërkuara të matjes përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instrumente portative shumë-funksionale për matjen dhe regjistrimin e të dhënave dhe analizat e sistemeve elektrike me 3 faza; • instrument portativ për matjen e sistemeve elektrike me 3 faza dhe për 45 vlerësimin e të dhënave në pikun e ngarkesës së kërkesës dhe faktorin e ngarkesës së energjisë; • Njehsori portativ Lux, për përcaktimin e intensitetit të ndriçimit në sipërfaqet e punës; • matës i temperaturë dhe lagështisë; • kamerë me termografi infra të kuqe.

Afati për aplikim prej 09 Shtator 2020 – 30 Shtator 2020, ora 16:00.

Adresa zyrtare për dorëzimin e aplikacioneve është AKEE, vetëm përmes postës elektronike në adresën, bahtie.morina@rks-gov.net.